



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .12.2024

MBLEDHJA Nr. 57,
Datë 30.12.2024, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 30.12.2024, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 57 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022 dhe vendimit nr. 72, datë 15.04.2024.
2. Mbi miratimin e Listës së Tarifave të ALPEX të cilat do të jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2025.
3. Mbi miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (sh.a KESH)” për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin për periudhën 01.10.2023 - 30.09.2024.
5. Mbi shqyrtimin e propozimit të FTL sh.a. të draft “Marrëveshjes për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë”.
6. Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 06.06.2023.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
8. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI